

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK

DEPARTAMENTI FINANCIAR

ABSTRAKT I TEMËS SË DIPLOMËS



PROGRAMI I STUDIMEVE : Fakulteti Juridik “Programi Juridiko – Financiar”

KADIDATI: Ilir Berisha

MENTOR: Prof. Dr. Mejdi Bektashi

TITULLI I TEMËS: “ANËTARËSIMI I SHTETEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN NË EURO ZONË DHE TRAKTATI I MAASTRICHT-IT”

Punimi i temës master me titull “ANËTARËSIMI I SHTETEVE TË BASHKIMIT EVROPIAN NË EURO ZONË DHE TRAKTATI I MAASTRICHT-IT” të kandidatit Ilir Berisha është i hartuar në 68 faqe.

Punimi ndahet në 4 kapituj.

Kapitulli I:

1. Traktati i Mاستrihtit
2. Shtetet nënshkruese të Traktatit të Mاستrihtit
3. Roli dhe rëndësia e Traktatit në themelimin e Bashkimit Evropian
4. Mاستrihti dhe tre shtyllat si masa mbrojtëse

Në kapitullin I kryesisht përqendrohem në rëndësinë e Traktati të Mastrohit duke filluar qysh nga Plani Verner në vitin 1970 dhe rolin e tij në krijimin e Bashkimit Evropian. Duke pasur parasysh se Traktati i Mastrohit pasqyrohet si pikë kthese në procesin e integritimit evropian, atëherë në këtë kapitull është dhënë një vështrim i përgjithshëm rreth rëndësisë dhe shtyllave kryesore të tij.

Kapitulli II:

1. Politikave ekonomike të Bashkimit Evropian
2. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian dhe kushtet që duhet të plotësohen
3. Struktura dhe funksionimi i Bashkimit Evropian
4. Integrimi Ekonomik në Bashkimin Evropian

Në kapitullin II është dhënë një vështrim i përgjithshëm mbi përkufizimin e politikave ekonomike të Bashkimit Evropian, kushteve dhe proceseve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Kështu, gjatë këtij kapitulli, do të përshkruajmë faktet dhe mënyrat e integritimit ekonomik në Bashkimin Evropian. Duke pasur parasysh se Bashkimi Evropian aplikon procedurë gjithëpërfshirëse të miratimit me anë të cilave sigurohet anëtarësimi i shteteve të reja, atëherë, ato janë përmbledhur hap pas hapi në këtë kapitull.

Më tej, shqyrtohet kuadri institucional i BE-së, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Bankës Qendrore Evropiane, Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Bashkimit Evropian. Përgjatë kapitujve, ofrohen njohuri të vlefshme në proceset e vendimmarrjes dhe dinamikat e pushtetit që mbështesin qeverisjen e BE-së

Kapitulli III:

1. Lindja e Euros dhe Eurozonës
2. Funksionimi i politikave fiskale në Eurozonë
3. Sistemi Evropian monetar dhe rëndësia e tij
4. Kriza ekonomike në Eurozonë, arsyet dhe pasojat
5. Kriteret për anëtarësim/pjesëmarrje në Eurozonë

Pasi që politikave fiskale kanë një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike, stabilitetin makroekonomik dhe inflacionin dhe, duke pasur parasysh rolin e ndërveprimeve të politikës fiskale-monetare në stabilizimin makroekonomik, i cili është bërë më i spikatur që nga kriza globale financiare, përgjatë këtij kapitulli do të vështrijmë rëndësinë e aplikimit dhe funksionimit të politikave fiskale në Eurozonë, arsyet e krizës ekonomike dhe kriteret që duhet plotësuar për anëtarësim/pjesëmarrje në Eurozonë.

Kapitulli IV:

1. Pakti për Stabilitet dhe Zhvillim
2. Roli ndërkombëtar i Euros
3. Integrimi politik dhe fiskal në Eurozonë

4. Banka Qendrore Evropiane dhe rëndësia e saj për funksionimin e BE-së

Gjatë kapitullit IV do të shtjellohen faktet lidhur me rolin e Bankës Qendrore në menaxhimin e politikës monetare në Eurozonë. Roli kryesor i Bankës në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, rëndësia e saj në funksionimin e Bashkimit Evropian, gurët e themelimit të Bashkimit Ekonomik Monetar, janë disa nga çështjet kryesore të cilat janë zhvilluar në këtë kapitull.

Fjalet kyqe: Traktati i Mاستrihtit, Bashkimi Evropian, Unioni Monetar, Banka Qendrore Evropiane, Sistemi Evropian Monetar.